




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK  
 Nr. Prot. 01-506/2013  
 Nr.faq. / Br. Prot. / Prot No. / Data / Datum / Date 20-02-2013  
 Broj stranica / Nr. pages 02  
 PRISTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.12.2012, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-2425/12.për. z. Haki Maxhuni, Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, në Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051.Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik.

Pas informatës së marre nga një E-mail anonime në adresë të AKK-së, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK–03-2425/12, që për trajtim ka pasur zyrtarin i lartë, z.Haki Maxhuni, Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, në Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si drejtor i njësisë së auditimit të brendshëm, në Ministrin e Tregtisë, njëkohësisht është i angazhuar edhe në një tjetër funksion publik.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.09.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Haki Maxhuni, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, më datën 09.10.2012, është organizuar takimi me z. Maxhuni, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari në

fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm, në Ministrinë e Tregtisë, dhe njëkohësisht e ushtron edhe pozitën e anëtarit të bordit në kompaninë regjionale të Ujësjetllësit "Mitrovica" ku është emëruar sipas konkursit publik, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjatë prezantimit të provave dhe argumenteve, zyrtari në fjalë është arsyetuar se, pozita si drejtor i njësisë së auditimit të brendshëm, në Ministrinë e Tregtisë, nuk ka role vendimmarrës, që mund të shkaktoj situatë të konfliktit të interesit me funksionin si anëtar i bordit në kompania regjionale të Ujësjetllësit "Mitrovica" dhe nuk mendon që gjendet në situatë të konfliktit të interesit, pasi që në funksionin si anëtar bordit nuk ka rol vendimmarrës dhe ekzekutiv dhe nuk merr pagë të rregullt

Andaj duke u bazuar në legjislacionin në fuqi: ligjin mbi Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 dhe Ligjin Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 15 pika 2, ku thotë se ( Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me pronë publike, mirëpo nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme), si dhe dëshmitë e mbledhura (kontratën e punës, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisive në punë), dhe duke vlerësuar gjendjen faktike dhe provat e mbledhura në rastin në fjale konstatojmë: se nuk ka elemente që dëshmojnë gjendjen e Konfliktit të Interesit, pasi që zyrtari i lartë z. Haki Maxhuni, si drejtor i njësisë së auditimit të brendshëm, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe angazhimi i tij si anëtar i bordit në kompaninë regjionale të Ujësjetllësit "Mitrovica" nuk paraqesin mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, dhe nuk ka elemente që dëshmojnë gjendjen e konfliktit të interesit, mirëpo gjithmonë duke u zbatuar neni 15 pika 2, e Ligjit Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

